



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61014-00806-2021 Regj. Themeltar
Nr. 00-2021- 871 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Illir PANDA	Kryesues
Albana BOKSI	Anëtare
Klodian KURUSHI	Anëtar

në datë 16.11.2021, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

KËRKUES:

1. Mimoza Margjeka
2. Arben Cara
3. Agnesa Cara (përfaqësuar nga prindërit e saj, Mimoza Margjeka dhe Arben Cara e mitur)

OBJEKTI: Zëvendësim i masë së sigurimit

BAZA LIGJORE: Neni 260 i Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP).

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarës Albana Boksi dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim prokuroria e posaçme) me datë 03.08.2020, ka shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrat e të hetuarve Nejton Bali, Klaudjo Zhilla dhe Skënder Demiraj, si të dyshuar për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të “Korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” parashikuar nga nenet 319 e 25 të Kodit Penal. Ndërkohë që është shënuar edhe emri i të hetuarve Arben Cara dhe Mimoza Margjeka, si të dyshuar për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë” të parashikuar nga nenet 319/ç e 25 i Kodit Penal.

2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim gjykata e posaçme), mbi kërkesën e prokurorisë së posaçme, me vendimin nr. 92, datë 05.09.2020, ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi”, për personat nën hetim

Mimoza Margjeka dhe Arben Cara, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit, dhe funksionareve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319/ç e 25 të Kodit Penal. Më datë 09.09.2020 është ekzekutuar vendimi nr.92, datë 05.09.2020 i gjykatës së posaçme, ndërmjet të tjerëve edhe për personat nën hetim Mimoza Margjeka dhe Arben Cara.

3. Më datë 12.09.2020, në zbatim të nenit 248/1 të KPP, gjykata e posaçme ka proceduar me marrjen në pyetje e të hetuarve, ku në verifikim të kushteve dhe të kriterëve të caktimit të masave të sigurimi personal, është disponuar caktimi i masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për personin nën hetim Arben Cara, parashikuar nga neni 237 të KPP. Nga ana tjetër, për shtetasen Mimoza Margjeka është disponuar caktimi i masës së sigurimit “detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 të KPP. Masa e caktuar për personin nën hetim Mimoza Margjeka është ndryshuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim gjykata e posaçme e apelit), duke i caktuar masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 të KPrP.

4. Në datë 11.01.2021, në zbatim të nenit 246/6, të KPP, prokurorët e çështjes kanë informuar me shkrim gjykatën (gjyqtarin e shqyrtimit të kërkesave në fazën e hetimit paraprak) mbi hetimet e kryera për procedimin penal nr. 186/2020, si dhe për nevojat e sigurimit në raport me të gjithë të dyshuarit. Ndërkohë, edhe personi nën hetim Mimoza Margjeka, ka paraqitur më datë 13.01.2021 kërkesën për informim me bazë ligjore nenin 246 pika ‘6’ të KPP.

5. Gjykata Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 15, datë 01.02.2021, (ndër të tjera) ka vendosur: *“Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për personin nën hetim Mimoza Margjeka dhe Arben Cara”*. Me vendimin nr.106, datë 14.04.2021, gjykata e posaçme e apelit, mbi ankimin e të hetuarës Mimoza Margjeka ka miratuar këtë vendim.

6. Në datë 22.01.2021, prokuroria e posaçme u ka njoftuar ankuesve Mimoza Margjeka dhe Arben Cara përfundimin e hetimeve për procedimin penal nr.186/2020, në ngarkim të tyre. Në datë 26.02.2021, prokuroria e posaçme ka depozituar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq me akuzat përkatëse, për secilin nga të pandehurit në këtë procedim, përfshi kërkuesit.

7. Në datën 24.02.2021, kërkuesit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara i janë drejtuar gjykatës së posaçme të shkallës së parë, me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, si dhe caktimin e Zyrës Sociale pranë Bashkisë Tiranë, për t’u kujdesur për vajzën e tyre të mitur Agnesa Cara., për arsimimin, trajtimin me psikolog, dhe aktivitetin ditor të nevojshëm për të. Kërkesa është paraqitur në emër e për llogari të të miturës Agnesa Cara, nga prindërit e saj (kërkuesit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara). Kjo kërkesë është paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake, i cili me vendimin e datës 01.03.2021, ka shpallur moskompetencën funksionale të trupit gjykues monokratik, për gjykimin e kësaj kërkesë, duke ja përcjellë kërkesën gjyqtarit të seancës paraprake.

8. Gjatë periudhës së shqyrtimit të kësaj kërkesë penale (me nr. 79 akti), me vendimin e datës 07.05.2021, gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar dërgimi për gjykim të procedimit penal nr.186/2020. Ndërkohë, në lidhje me kërkesën objekt gjykimi, gjyqtari i seancës paraprake me vendimin datë 11.05.2021, ka vendosur *“Shpalljen e moskompetencës funksionale të këtij trupi gjykues (gjyqtarës së seancës paraprake) për gjykimin e kërkesës penale me nr.79akti e dt.24.02.2021 që i përket kërkuesve/të pandehurve Mimoza Margjeka dhe Arben Cara, me objekt : “Zevendesimi i mases se sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 të KPrP, të dhënë ndaj tyre si dhe caktimin e Zyrës Sociale pranë Bashkisë Tiranë, për t’u kujdesur për të miturën Agnesa Cara për arsimimin, trajtimin me psikolog, argëtimin dhe nevojat e tjera të moshës gjatë periudhës së aktivitetit ditor të nevojshëm”*. Dërgimin për shqyrtimin të kërkesës së bashku me aktet e saj, trupit gjykues të

Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të gjykimit në themel të procedimit penal nr.186, të vitit 2020. Gjykata e themelit, e cila ishte caktuar me shortin e dt.14.05.2021, pasi u njoh me kërkesën ka caktuar brenda 5 (pesë) ditëve seancën gjyqësore.

9. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 79, datë 21.05.2021, (objekt ankimi), ka vendosur: “*Rrëzimin si të pabazuar të kërkesës ...*”. Kjo gjykatë ka argumentuar se, në respektim të nenit 260 të KPP, në verifikim të kushteve për zbutjen e masës së sigurimit të zbatimit të masës së sigurimit personal dhe nevojave të sigurimit për kërkuesit, në referim dhe të parashikimeve të 228, 229 dhe 230 të KPP, çmon ekzistencën dhe nevojën e vazhdimësisë së zbatimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”.

10. Në arsyetimin e saj, gjykata e posaçme e shkallës së parë ndër të tjera ka analizuar faktin se: “*...Nga momenti që është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”, deri në datën e paraqitjes së kësaj kërkesë vazhdojnë të ekzistojnë të njëjtat kushte, pasi kërkuesve Mimoza Margjeka dhe Arben Cara u është komunikuar e njëjta akuzë për të cilën është caktuar masa e sigurimit, që do të thotë se nuk janë zbutur rrethanat, parashikuar nga neni 260/2 i KPP. Në këtë moment procedural kërkuesit janë çuar për gjykim me statusin e të pandehurve. Gjykata nuk konstatoi ndonjë shkak padënueshmërie për kërkuesit, si dhe ekziston rreziku të ndikimit të tyre tek provat, sidomos të provave me dëshmitarë, duke pasur parasysh sanksionin dhe veprën penale. Në lidhje me mundësinë e ndryshimit të masës së sigurimit për shkaqe shëndetësore, gjykata pasi ka administruar provat e paraqitura nga kërkuesi Arben Cara, ka kryer aktin e ekspertimit mjeko ligjore nr.779 i datës 22.04.2021, sipas të cilit gjëndja e kërkuesit nuk është e tillë që të vërë në rrezik shëndetin e tij dhe mund të kurohet në kushtet e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”. Në lidhje me pretendimin për trajtimin me psikolog, argëtim, arsimim dhe nevojave të tjera të të miturës Agnesa Cara, gjykata e gjen të pa bazuar këtë kërkesë, duke ju referuar ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku kërkuesit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara në kushtet që ndodhen mund t’i drejtohen Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, pranë Bashkisë Tiranë, për të plotësuar nevojat e të miturës për ndihmë për trajtimin me psikolog, argëtim, arsimim dhe nevojave të tjera të saj.*

11. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit Mimoza Margjeka, Arben Cara dhe e mitura Agnesa Cara (përfaqësuar nga prindërit e saj, Mimoza Margjeka dhe Arben Cara). Ankimet janë paraqitur të veçanta, por përmbajnë të njëjtat shkaqe, duke kërkuar revokimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, për kërkuesit ose në alternativë për kryefamiljarin Arben Cara, duke bërë zëvendësimin me një masë më të butë, për shkak se, nuk ekzistojnë më kushtet dhe nevojat e sigurimit, për shkakun e rrethanave familjare, sikurse është pasja e një fëmije të mitur dhe nevojave të saj për për ndihmë për trajtimin me psikolog, argëtim, arsimim dhe nevojave të tjera të saj. Nga kërkuesja Mimoza Margjeka dhe mbrojtësi i saj, është paraqitur një kërkesë për shpalljen e moskopesencës lëndore të gjykatës së posaçme të apelit, duke kërkuar që kjo gjykatë të mos ta shqyrtojë kërkesën për shkak se, duke kaluar çështja në themel duhet ta gjykojë trupa gjyqësore që do të gjykojë në themel çështjen në Apel.

12. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 147, datë 16.06.2021, ka vendosur: “*1.Miratimin e vendimit nr. 79, datë 21.05.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Mospranimin e ankimit të paraqitur në emër të shtetasës Agnesa Cara, nga Arben Cara, dhe avokatët Loren Liço e Sokol Hazizaj ndaj vendimit nr.79, datë 21.05.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”.

13. Gjykata e posaçme e apelit ndër të tjera ka argumentuar se: “*... Në lidhje me të drejtën e ankimit për kërkesën e bazuar në nenin 260 të KPP, me ndryshimet të ligjit nr. 41/2020*

“Për disa shtesa dhe ndryshime ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, Kodi Procedurës Penale” (hyrë në fuqi më datë 29.05.2021), rezulton se (tashmë), kundër vendimit të gjykatës së themelit për caktimin, zëvendësimin ose rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e masës së sigurimit, lejohet ankimi pasi ndryshimet kanë sjellë pasoja pozitive për të pandehurit. (...) Lidhur me ankimin e shtetases së mitur Agnesa Cara, e nënshkruar nga prindërit e saj (kërkuesit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara) si dhe avokatet e këtyre të fundit, gjykata e posaçme e apelit ka vlerësuar se nuk duhet të pranohet, duke vendosur mospranim për shkak se, ankimi është bërë nga një person që nuk legjitimohet, parashikuar nga neni 422 të K.Pr.Penale.

14. Në lidhje me pretendimet e ankuesve Mimoza Margjeka dhe Arben Cara, për moskompetencën e trupit gjykues, për gjykimin e ankimit për disponimin mbi kërkesat gjatë fazës së gjykimit në themel në shkallë të parë, të njëjtët gjyqtarë apeli, që kanë shqyrtuar ankimet mbi disponimet e gjyqtarit të hetimeve paraprake, gjykata e posaçme e apelit ka arsyetuar se : *“Vendimi i ankimuar është dhënë nga trupi gjykues që po gjykon themelin e çështjes në shkallë të parë, dhe është e qartë që në gjykatën e posaçme të apelit nuk ka një çështje për gjykim të regjistruar, pra aktet nuk gjenden pranë kësaj gjykatë për gjykim. Në këtë fazë të procedimit e vetmja gjykatë për të cilën kompetenca funksionale përfshin dhe gjykimet për masat e sigurimit është gjykata ku ndodhen aktet, që është Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (referuar dhe vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka unifikuar praktikën se, me paraqitjen e kërkesës për gjykim, kompetenca për të disponuar mbi kërkesat e ankesat lidhur me masat e sigurimit kalon ipso jure të gjykata që shqyrton themelin e akuzës).”*

15. Gjykata e posaçme e apelit në lidhje me kërkesën për zëvendësimin e masave të sigurimit caktuar ndaj kërkuesve, ndër të tjera ka theksuar se, *shkaqet e parashtruara në ankim dhe pretendimet e paraqitura në gjykimin në apel, nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe në prova, përse i përket pretendimeve se, janë marrë provat nga organi i akuzës, pasi nuk përbën argument për të konkluduar në zbutjen e nevojave të sigurimit, në zbatim të nenit 260 të KPP. Vijon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova në kuptim të nenit 228, pika 1 të KPPenale, se kërkuesit (tashmë në cilësinë e të pandehurve) kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen. Për ankuesit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara vijojnë të mos konstatohen shkaqet padënueshmërie, për efekt të ligjit penal dhe masa e sigurimit personal “arrest në shtëpi” për ta, vijon të vlerësohet që është masa më e përshtatshme, për të zbehur rrezikun e ndikimit të saj në provat, veçanërisht ato me dëshmitarë. Theksohet se ndryshe nga sa pretendohet në ankim, dërgimi i çështjes për gjykim nuk e zbeh këtë rrezik, pasi prova në fakt krijohet gjatë gjykimit dhe jo gjatë hetimit dhe për pasojë ky kolegji vlerëson se plotësohet një ndër kushtet e nenit 228, pika 3 e KPP. Gjithashtu, nuk kanë ndryshuar as kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 228 dhe 229 të KPP, mbi bazën e të cilave është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”. Kjo masë është më e përshtatshme duke pasur parasysh rëndësinë e faktit penal që i është atribuar, mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe masën e dënimit të parashikuar nga neni 319/ç i KPP, si dhe ekzistencën e rrethanës rënduese të bashkëpunimit. Konstatohet se, nuk jemi përpara situatës së zbutjes së masës në zbatim të nenit 260 të KPP, sipas të cilës” “...kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit dhe dënimit që mund të caktohet”. Ankuesve u është komunikuar pikërisht ajo akuzë për të cilën ata gjenden tashmë nën masën e sigurimit “arrest në shtëpi”. Fokusuar në shkaqet e ankimit të lidhura me gjendjen familjare se, ka fëmijë të mitur për t’u kujdesur, gjykata arsyeton se, fakti i të qënurit të ankuesve nën këtë masë siguri mi me karakter shtrëngues duhet parë në harmoni me rrezikshmërinë e lartë shoqërore që paraqet vepra penale e parashikuar nga neni 329/ç në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, për të cilën ata akuzohen dhe që ka një nivel dyshimi të arsyeshëm që e kanë kryer. Referimet e ankuesve*

ne nenin 27 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, janë për caktimin e masave të sigurimit për të miturit. Pavarësisht rrezikshmërisë së lartë të veprës, të dy kërkuesit nuk gjenden nën masën e sigurimit ekstrem “arrest në burg” dhe për shkak se, ankuesia Mimoza Margjeka është nënë e një fëmijë 4 (katër) vjeç është caktuar ndaj saj masa e sigurimit “arrest në shtëpi”. Për sa i përket ankuesit Arben Cara, dhe pretendimeve të tij se, ka shkaqe shëndetësore për ndryshimin e masës, gjykata arsyeton se, nga Gjykata është marrë parasysh ky fakt kur është bërë ndryshimi i masës nga “arrest në burg”, në “arrest në shtëpi”. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e ka gjetur të drejt vlerësimin që ka bërë Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila ka vlerësuar se gjëndja e ankuesit Arben Cara nuk është “veçanërisht e rëndë”, të përcaktuar në nenin 230/2 të KPP. Për këtë arsye është kryer dhe akti i ekspertimit mjeko ligjor. (...)”

16. Kundër vendimit nr. 147, datë 16.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka depozituar rekurs, depozituar nëpërmjet shërbimit postar më datë 22.07.2021, mbërritur në gjykatë më datë 23.07.2021, personi nën hetim Mimoza Margjeka dhe për të miturën Agnesa Cara, përfaqësuar nga av.Loren Liço, me të cilin kërkon ndryshimin e këtyre vendimeve, ndryshimin e masës së sigurimit, duke vendosur një masë më të butë ose urdhërimin e shërbimeve sociale, pranë Bashkisë Tiranë për tu kujdesur për të miturën Agnesa Cara, gjatë aktiviteteve sociale.

17. Kundër vendimit nr. 147, datë 16.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka depozituar rekurs, depozitura në shërbimin postar më datë 22.07.2021, mbërritur në gjykatë më datë 23.07.2021, personi nën hetim Arben Cara dhe për të miturën Agnesa Cara, përfaqësuar nga av.Sokol Hazizaj, me të cilin kërkon ndryshimin e këtyre vendimeve, ndryshimin e masës së sigurimit, duke vendosur një masë më të butë ose urdhërimin e shërbimeve sociale, pranë Bashkisë Tiranë për tu kujdesur për të miturën Agnesa Cara, gjatë aktiviteteve sociale. Në mënyrë të përmbledhur në rekurs janë parashtruar këto shkaqe (shkaqet e rekursit janë të njëjta):

- Vendimi i rekursuar bie ndesh në mënyrë të hapur me vendimin unifikues nr.7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, se me paraqitjen e kërkesës për gjykim, kompetenca për disponimin mbi kërkesat dhe ankesat lidhur me masat e sigurimit kalon “*ipso jure*” te gjykata që shyrton themelin e akuzës. Kompetente nuk është më gjykata e hetimeve paraprake dhe kjo nuk vlen vetëm për shkallën e parë, por për të gjitha shkallët e gjykimit. Edhe në apel nuk mund të jenë kompetentë gjyqtarët që kanë shqyrtuar kërkesa gjatë hetimeve paraprake.

- Vendimi i gjykatës së apelit është haptazi i paarsyetuar dhe nuk merr në shqyrtim shkakun kryesor për të cilën është bërë kjo kërkesë (gjëndjen psikiko-psikologjike të vajzës së kërkuesve). Pasi koha që po kalon vajza në shtëpi e pengon për tu regjistruar në arsimin parashkollor, duke qënë se moshja e saj është 5 vjeç.

- Gjykata arsyeton në vendimin e saj se, interesi i përgjithshëm mbizotron mbi lirinë personale të individit kjo e garantuar ne nenin 27 të Kushtetutës dhe 51 të Konventës për të drejtat e njeriut, duke mos e përmendur në arsyetimin e saj, parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

- Gjykata në lidhje me rrezikun e ndikimit të pandehurve mbi provat, veçanërisht me dëshmitarë, nuk ka paraqitur asnjë emër dëshmitari i cili bën provë të rëndësishme që do të bënte të mundur “*helimin e kësaj prove*”, me ndryshimin e masave. E pandehura Mimoza Margjeka ka qëndruar gati 1 (një) muaj me masë siguri “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore”, dhe nuk është parashtruar asnjë pretendim në lidhje me këtë fakt.

- Në lidhje me pretendimin e gjykatës se, kërkesa e të miturës Agnesa Cara, duhet mospranuar për shkak se, është firmosur vetëm nga kërkuesi/përfaqësuesi ligjor i të miturës, nuk qëndron për arsye se të dy prindërit janë përfaqësues ligjor të të miturës.

- Gjykata duhet ta bazojë vendimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e një justifikimi dhe arsytimi të përshtatshëm për sa i përket paraburgimit apo arrestit në shtëpi, në praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*Clooth k. Belgjikës, Yagci dhe Sargin k. Turqisë etj.*). Në lidhje me rrezikun e largimit, GJEDNJ ka deklaruar se, nuk bazohet vetëm në ashpërsin e dënimit, por dhe në kritere të tjera si karakteri personit, morali, lidhjet familjare, pasuria, (*Çështja Neumeister K Austrisë*” viti 1968, *Smirnova k Rusisë*”, *“Letellier k Francës etj”*).

- Në rastin konkret hetimet janë përfunduar dhe është njoftuar akuza, çka e bën situatën të ndryshme nga momenti që është caktuar masa e sigurimit. Shtetasit Mimoza Margjeka dhe Arben Cara nuk ushtrojnë më funksionet e tyre, që e bën të pamundur kryerjen e veprave të tjera penale.

- Të gjitha provat janë marrë dhe e bën të pamundur ndikimin e nuk mund të ketë një masë sigurimi edhe për shkak të nevojave të vajzës së mitur, e cila de jure dhe de facto është nën masë sigurimi, pasi nëna, ashtu dhe babai i saj janë në masë sigurimi “arrest në shtëpi”, duke bërë të pamundur që fëmija 4 vjeçar të shkojë në kopsht, apo të zhvillojë aktivitete të përshtatshme për moshën e saj. Për të miturën është krijuar artificialisht një ndalim i paligjshëm në kundërshtim dhe me disa praktika të GJEDNJ-së.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) së pari vlerëson se, në lidhje me masat e sigurimit, e drejta për të ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, është parashikuar shprehimisht në pikën 8 të nenit 249, të KPP, ku theksohet se “*Rekursi në Gjykatën e Lartë lejohet për shkelje të ligjit, brenda kompetencës së saj*”. Në këtë vështrim, rekursi në lëndë të masave të sigurimit duhet të evidentojë shprehimisht shkeljen e ligjit, e lidhur kjo edhe me sa parashikon neni 432 i KPP, ku janë parashikuar shkaqet për të cilat lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë.

19. Kolegji vlerëson se, rekursitet e depozituara nga kërkuesit i plotësojnë kushtet formale, pasi rezulton se janë nënshkruar nga mbrojtësit dhe janë paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në KPP. Të gjitha palët janë njoftuar për rekursitet e paraqitura.

20. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, sipas ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të rekursit, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet a) *për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

21. Kolegji paraprakisht vlerëson se, edhe në rastin e rekurseve në lëndë të masave të sigurimit, shqyrtimi i tyre lidhet ngushtësisht me pretendimet për shkelje të ligjit. Në këtë vështrim, shqyrtimi i fakteve dhe i provave/akteve edhe në këtë rast, del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Në të gjitha rastet kur rekursi nuk i përmbahet shkaqeve të përcaktuara nga neni 432/1 i Kodit të Procedurës penale, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

22. Kolegji vlerëson se, rekursitet e paraqitura nuk përmbajnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP. Lidhur me pretendimet e parashtruara në rekurs që lidhen

me zbatimin e nenit 260 vlerësuar me kushtet e kriteret e parashikuara në nenet 228, 229 e 230 të KPP, Kolegji konstaton se ato kanë marrë përgjigje shteruese nga gjykatat e posaçme. Kolegji vlerëson se, gjykatat e posaçme kanë zbatuar drejt kërkesat e nenit 260 të KPP, duke disponuar me rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit. Gjykata e posaçme kanë argumentuar kërkimin për zëvendësimin e masës së sigurimit në raport me nevojat e sigurimit duke analizuar ekzistencën e kushteve e kriterëve për caktimin e masave të sigurimi në raport me provat e paraqitura nga palët, duke konkluduar se në rastin konkret këto nevoja sigurimi nuk janë zbutur. Provat e depozituara nga kërkuesit janë marrë në shqyrtim edhe në gjykimet e mëparshme nga gjykatat e posaçme, e në këto kushte ato nuk konsiderohen si prova të reja që diktojnë zëvendësimin e masës së sigurimit.

23. Kolegji evidenton se, gjykata e posaçme e apelit ka arritur konkluzione të drejta edhe në lidhje me kërkesën e paraqitur në emër e për llogari të fëmijës së mitur Agnesa Cara, nga kërkuesit si përfaqësues ligjore të saj. Në këtë vështrim, nuk qëndron pretendimi i parashtuar në rekurs se, nga gjykata e posaçme e apelit nuk është vlerësuar parimi i “interetit më të lartë i të miturit”. Gjykata e posaçme e apelit ka shpjeguar si pozitën procedurale të të miturës ashtu edhe mundësitë ligjore që parashikohen në zbatim të ligjit “Për të drejtat e fëmijëve”, për mbrojtjen e interesit të të miturës dhe respektimin e parimit të interesit më të lartë të saj, të cilat mund të realizohen nëpërmjet institucioneve përkatëse.

24. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. 147 datë 16.06.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 dhe 441/1-a të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit Mimoza Margjeka, Arben Cara dhe Agnesa Cara (e mitur), kundër vendimit nr.147, datë 16.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më 16.11.2021

A N Ë T A R

Klodian KURUSHI

A N Ë T A R E

Albana BOKSI

K R Y E S U E S

Illir PANDA